



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VLORE

V E N D I M
Nr. 57, datë 11.12. 2014

P Ë R
MIRATIMIN E KRITEREVE TE DHËNIES SË KONÇESIONIT PËR ADMINISTRIMIN E
SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË

Mbështetur në nenin 7 pika 2, nenin 10 pika 1, nenin 32, i ndryshuar të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", nenin 7 pika 8 gërma "c", të ligjit nr. 8378, datë 22.08.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), nenin 13/1/c të Udhëzimit nr.7, datë 10.06.2008 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit "Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit/ve me pagesë në rrugë", si dhe nenin 4/1/a të Ligjit nr.125/2013 "Për konçesionet dhe partneritetin publik privat", VKB nr. 17, datë 29.06.2007 "Për sistemimin e të gjithë vendparkimeve në qytetin e Vlorës të mjeteve motorrike taks-autobuza", i ndryshuar me VKB nr.19, datë 26.04.2012 dhe VKB nr.45, datë 20.09.2012, VKB nr.45 dt.09.10.2014 "Për miratimin e dhënies së konçesionit për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë", studimin e fizibilitetit të kryer për këtë qëllim dhe rekomandimeve të nxjerra prej tij, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Keshilli i Bashkisë Vlorë.

V E N D O S I

1. Të miratojë dhënien me konçesion, si një nga format e bashkëpunimit midis njësisë vendore dhe subjekteve private, të administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë të rrugëve publike në qytetin e Vlorës, sipas emërtimeve, koeficientëve dhe orarit, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Afati i dhënies me konçesion të administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë të rrugëve publike në qytetin e Vlorës të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
3. Tarifa vjetore e konçesionit të jetë 10 (dhjetë) milion lekë në vit për dy vitet e para dhe nga viti i tretë e në vazhdim 10 (dhjetë) milion lekë në vit plus 2 % të xhiros vjetore të realizuar.
4. Te autorizojë Kryetarin e Bashkisë Vlorë për të vazhduar procedurat ligjore për dhënien e konçesionit për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë në qytetin e Vlorës.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenint 33/6 të ligjit nr.8652 dt.31.07.2000.


Evis ALLUSHI
KRYETARE

